



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 65

Gusht

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.197, datë 19.2.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.429, datë 30.8.1993 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e komitetit qeveritar të bisedimit të borxhit të jashtëm”, të ndryshuar..... 3
Vendim i KM nr.207, datë 25.2.2009	Për miratimin e rregullores për kontrollin në anë të rrugës dhe në zyrat e ndërmarrjeve, për sa i përket zbatimit të rregullave të kohës së punës, për personat, që kryejnë transport rrugor, dhe për orët e drejtuesve të mjeteve..... 3
Vendim i KM nr.217, datë 2.2.2009	Për dhënien në përdorim komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale, të një pjese të ndërtesës së ish-Ministrit të Transporteve e Telekomunikacioneve..... 11
Vendim i KM nr.219, datë 6.3.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe të veprimtarive sezonale/të përkohshme, për ministrinë dhe institucionet buxhetore”..... 13
Vendim i KM nr.220, datë 6.3.2009	Për përcaktimin e numrit të punonjësve mësimorë, me kontratë të përkohshme, për periudhën janar-qershor 2009, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës..... 13
Vendim i KM nr.239, datë 21.1.2009	Për miratimin e programit afatmesëm ekonomik dhe fiskal, të Shqipërisë, 2008-2011..... 17

Vendim i KM nr.251, datë 12.3.2009	Për miratimin e marrëveshjes së ndryshuar, ndërmjet Alpetrol, sh.a.-së, dhe Bankers Petroleum Albania, Ltd, për marrëveshjen hidrokarbure të datës 19 qershor 2004, miratuar me vendimin nr.477, datë 16.7.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në vendburimin e Patos-Marinzës”.....	18
Vendim i KM nr.258, datë 12.3.2009	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 1.12.2008, për çështjen “Xheraj kundër Shqipërisë”.....	22
Vendim i KM nr.265, datë 12.3.2009	Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.343, datë 27.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e burimeve dhe të procedurave të financimit të dëmeve pasurore, të shkaktuara nga aksidenti teknologjik i Gërdecit”, i ndryshuar	23
Vendim i KM nr.268, datë 18.3.2009	Për financimin e veprimtarive festive “Shqipëria në NATO”...	24
Vendim i KM nr.273, datë 18.3.2009	Për kalimin në pronësi të bashkisë Shkodër të ndërtesës “Prefektura Shkodër”.....	24
Vendim i KM nr.274, datë 18.3.2009	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogave dhe krimit të organizuar.....	27

VENDIM
Nr.197, datë 19.2.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.429, DATË 30.8.1993 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT QEVERTAR TË BISEDIMIT TË
BORXHIT TË JASHTËM”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, të Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e vendimit nr.429, datë 30.8.1993 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1/. Komiteti qeveritar i bisedimit të borxhit të jashtëm, që më poshtë do të quhet Komiteti, ka këtë përbërje:

- | | |
|--|------------------|
| - Ministri i Financave | kryetar; |
| - Guvernatori i Bankës së Shqipërisë | zëvendëskryetar; |
| - Ministri i Drejtësisë | anëtar; |
| - Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës | anëtar; |
| - Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit të Borxhit,
në Ministrinë e Financave | anëtar; |
| - Drejtori i Departamentit të Operacioneve
Monetare, në Bankën e Shqipërisë | anëtar; |
| - Ekspert, vendas apo i huaj | anëtar.” |
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.207, datë 25.2.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KONTROLLIN NË ANË TË RRUGËS DHE NË
ZYRAT E NDËRMARRJEVE, PËR SA I PËRKET ZBATIMIT TË RREGULLAVE TË
KOHËS SË PUNËS, PËR PERSONAT, QË KRYEJNË TRANSPORT RRUGOR, DHE PËR
ORËT E DREJTUESVE TË MJETEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 172 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore për kontrollin në anë të rrugës dhe në zyrat e ndërmarrjeve, për sa i përket zbatimit të rregullave të kohës së punës, për personat, që kryejnë transport rrugor, dhe për orët e drejtuesve të mjeteve, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Brendshme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLAT

MBI KONTROLLIN NË ANË TË RRUGËS DHE NË ZYRAT E NDËRMARRJEVE, PËR SA I PËRKET ZBATIMIT TË RREGULLAVE, TË KOHËS SË PUNËS PËR PERSONAT QË KRYEJNË TRANSPORT RRUGOR, DHE PËR ORËT E DREJTUESVE TË MJETEVE

1. Organet e kontrollit në rrugë, sipas nenit 12 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar ushtrojnë kontroll në zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullores për organizimin e kohës së punës të personave, që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit” dhe ligjit nr.9514, datë 18.4.2006 “Marrëveshja europiane “Për punën e ekuipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor (AETR)” dhe në protokollin e nënshkrimit e në amendamentin nr.4 të saj”, nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari transporti rrugor.

2. Organet e kontrollit në rrugë organizojnë një sistem të përshtatshëm dhe të rregullt, lidhur me kontrollet që duhet të kryejnë në anë të rrugës dhe ose në zyrat e ndërmarrjeve të transportit, për sa i përket:

a) Numrit të ditëve të punuara nga drejtuesit e mjeteve:

b) Numrit të përgjithshëm dhe llojin e shkeljeve të regjistruara, për sa i përket drejtimit ditor, javor ose dyjavor të mjetit;

c) Shkeljeve të regjistruara për sa i përket periudhës së ndërprerjes ose për shkeljet e regjistruara për sa i përket pushimit ditor e javor, për transportuesit shqiptarë ose për ata që janë të regjistruar në KE ose në vendet e treta:

ç) Llojit të tahogرافit: analog ose dixhital, dhe

d) Llojit të veprimtarisë së transportit, nëse veprimtaria është transport brenda vendit ose ndërkombëtar, për mallra ose udhëtarë, për llogari të vet ose për të tretë ose me qira;

të të gjitha kategorive të transportit të përfshira në rregulloren e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008 dhe, ose në AETR-në. Modelet e pasqyrimin të këtyre kontrolleve përcaktohen me udhëzim të ministrit, në përputhje me modelet standard që përdorin shtetet anëtare të KE-së.

Modelet për mjetet e përshtatshme për udhëtarë me nëntë persona, përfshirë edhe drejtuesin e mjetit, të licencuar në shërbimin taksi dhe, ose linja rrethqytetëse sipas shkronjës c” dhe “ç” të pikës 2.1 të rregullores për organizimin e kohës së punës së personave, që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008, do të përdoren vetëm për qëllime të brendshme dhe jo për qëllime shkëmbimi informacione me shtetet e tjera.

3. Numri i kontrolleve përfshin çdo vit një numër sa më të gjerë të punëtorëve që kryejnë veprimtari transporti rrugor të lëvizshëm, drejtuesve të mjeteve, ndërmarrjeve dhe mjeteve, të të gjitha llojeve të kategorive të transportit të përfshira në rregulloren e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008 dhe, ose në AETR.

Gjatë kontrollit, gjithashtu, organet e kontrollit në rrugë verifikojnë përputhshmërinë me kohën e punës mesatare, javore, për punëtorët e lëvizshëm, në një periudhë reference të zgjedhur 17 ose 26 javë. Llogaritja e kohës së punës për punëtorin e lëvizshëm dhe zgjedhja e llojit të periudhës referencë përcaktohen me udhëzim të ministrit.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) koordinon dhe ndjek veprimet e ndërmarra për kontrollin në anë të rrugës dhe kontrollin në zyra ndërmjet organeve të kontrollit, në përputhje me dispozitat e këtij vendimi. Në kontrollet në zyra, krahas organeve të kontrollit të pikës 1, merr pjesë edhe Inspektorati Shtetëror i Punës.

5. Kontrollet kryhen vetëm nga nëpunës të autorizuar të organeve të kontrollit, të cilët kanë kryer trajnimin e nevojshëm, mbi llogaritjen e kohës së punës, rregullat mbi orët e drejtimit të mjetit dhe rregullat mbi përdorimin e pajisjes së regjistrimit, pasi të kenë përfunduar me sukses një provim në përputhje me pikën 3 të nenit 22 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor drejton kualifikimin e nëpunësve të organeve të kontrollit në aftësimin e tyre, për kryerjen në përputhje me ligjin e korrekt të detyrës së tyre të ngarkuar për inspektim, deri me 31 dhjetor të 2009, sipas pikës 3 nenit 12 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998.

6. Organet e kontrollit do të fillojnë kontrollin në një mënyrë të tillë, që duke filluar nga 1 janari 2010 të kontrollojnë 1% të ditëve të punuara nga drejtuesit e mjeteve. Përqindja do të rritet në 2% nga 1 janari 2012 dhe të paktën në 3% nga 1 janari 2015.

Nga 1 janari 2015 kjo përqindje minimale do të rritet në 4%, me kusht që statistikave e mbledhura tregojnë që mesatarisht, më shumë se 90% e mjeteve të kontrolluara të jenë pajisur me tahograf dixhital.

7. Nga 1 janari 2010, jo më pak se 15% e numrit të përgjithshëm të ditëve të punës të kontrolluara do të kontrollohen në anë të rrugës dhe jo më pak se 30% në zyrat e ndërmarrjeve të transportit rrugor. Duke filluar nga 1 janari 2013 jo më pak se 30% e numrit të përgjithshëm të ditëve të punës të kontrolluara do të kontrollohet në anë të rrugës dhe jo më pak se 50% do të kontrollohet në zyrat e ndërmarrjeve.

8. Një informacion, i cili përmbledh të dhënat statistikore, për kontrollet e ushtruara sipas pikave 6 dhe 7 deri më 30 shtator të vitit në vijim, i cili është dhe fundi i periudhës dyvjeçare, do t'i dërgohet Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe institucioneve ndërkombëtare të interesuara, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).

Informacioni do të përfshijë numrin e drejtuesve të kontrolluar në anë të rrugës, numrin e kontrolleve në zyrat e ndërmarrjeve, numrin e ditëve të punës të punuara të kontrolluara dhe numrin dhe llojin e shkeljeve të raportuara për mallra ose udhëtarë, të cilat jepen në tabelat sipas pikës 6 dhe 7, e të vendosura në tabelat sipas pikës 2.

9. Organet e kontrollit dërgojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor të gjithë informacionin statistikor që zotërojnë nga kontrollet e ushtruara në përputhje me pikën 2, 6 dhe 7, kur shkeljet kanë ndodhur brenda kategorive si vijon:

a) Për kontrollet në anë të rrugës:

i) llojin e rrugës e klasifikuar sipas pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

ii) llojin e tahografit që përdoret: analog ose dixhital.

b) Për kontrollet në zyra:

i) llojin e veprimtarisë së transportit, nëse veprimtaria është ndërkombëtare ose brenda vendit, për udhëtarë ose mallra, për të tretë ose me qira, ose për llogari të vet;

ii) numrin e mjeteve të ndërmarrjes;

iii) llojin e tahografit që përdoret: analog ose dixhital.

Në realizimin e detyrave, organet e kontrollit duhet të jenë të pajisur me pajisje standard të përdorshme gjatë kontrollit në rrugë dhe, ose në zyra:

i) pajisje me aftësi të transferimit të të dhënave nga njësia e mjetit dhe karta e drejtuesit të mjetit nga tahografi dixhital, leximi i të dhënave, dhe analiza e të dhënave, dhe, ose transmetimi i përfundimeve të zbuluara të një *database* qendror për analiza;

ii) pajisje për kontrollin e fletëve të tahografit.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor publikon një raport dyvjeçar statistikor, të cilin ua dërgon organeve homologe, të shteteve anëtare të KE-së dhe, ose institucioneve ndërkombëtare të interesuara. Të dhënat e grumbulluara do të mbahen të regjistruara për vitin paraardhës e atij në vijim nga DPSHTRR-ja.

10. Organet e kontrollit gjatë kryerjes së detyrës në rrugë ose në zyra kontrollojnë dokumentet e regjistrimit që duhet të ruajë drejtuesi i mjetit dhe punëdhënësi. Këto dokumente dhe rezultatet e kontroleve të kryera nga organet e kontrollit në zyra ose për drejtuesit e tyre në anë të rrugës ruhen për të paktën një vit nga data e regjistrimit të fundit në zyrat e ndërmarrjes. Dokumentet e regjistrimit, që duhet të mbajë drejtuesi i mjetit dhe punëdhënësi, jepen në aneksin I, bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Ministri përcakton rregullat për mbajtjen, lëshimin dhe ruajtjen e regjistrimeve; lëshimin e bllokut të regjistrimit, si dhe mënyrën e përdorimit të bllokut të regjistrimeve dhe detyrimet në plotësimin e tyre nga punëdhënësi dhe drejtuesi i mjetit.

11. Kontrollat në anë të rrugës organizohen në vende të ndryshme dhe në çdo kohë duhet të mbulojnë një pjesë të gjerë e të mjaftueshme të rrjetit rrugor për të mënjanuar shmangien nga kontrolli të transportuesve.

Gjatë kontrollit në anë të rrugës, kur drejtimi i mjetit kryhet plotësisht në rrugët e brendshme sipas shkronjës “C”, të pikës 6 të nenit 2 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, koha e drejtimit llogaritet si detyrë ose “punë tjetër”, në përputhje me pikën 16, 17 dhe 18 të rregullores për organizimin e kohës së punës së personave, që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008. Nëse një pjesë e udhëtimit ose pushimi kryhet në rrugët, që nuk përfshihen në ato të përmendura në këtë paragraf, atëherë kjo periudhë do të llogaritet si kohë drejtimi.

12. Pikat e kontrollit në anë të rrugës caktohen në vende, të cilat plotësojnë kushte të mjaftueshme të sigurisë, përgjatë autostradave e rrugëve të tjera, të klasifikuara sipas Kodit Rrugor. Kontrollat në anë të rrugës kryhen me një sistem rotacioni e me një balancë gjeografike të përshtatshme.

13. Kontrollat në anë të rrugës, sipas rastit, mund të fokusohen në një pikë të veçantë, nëse e kërkon situata, dhe mbulojnë çështjet si vijon:

a) Kohën e drejtimit të mjetit ditore e javore, periudhat e ndërprerjeve dhe periudhat e pushimit ditor e javor; fletët e regjistrimit të tahografit për ditën aktuale plus 28 ditët kalendarike të mëparshme, të cilat duhet të mbahen në mjet; të dhënat e magazinuara për të njëjtën periudhë mbi kartën e drejtuesit të mjetit dhe/ose në memorien e pajisjes së regjistrimit në përputhje me aneksin I, të kësaj rregulloreje dhe/ose të printuara; ndonjë regjistrim manual ose printim periudhës së përmendur në këtë pikë.

b) Ditën aktuale plus periudhën prej 28 ditësh kalendarike të mëparshme, ku në të gjitha rastet shpejtësia e autorizuar e mjetit është kapërcyer. Kjo përcaktohet si të gjitha periudhat prej më shumë se një minutë gjatë së cilës shpejtësia e mjetit kapërcen 90 km/h për mjetet e kategorisë N3 ose 105 km/h për mjetet e kategorisë M3, sipas shkronjës “b” dhe “c” të pikës 2 të nenit 47 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

c) Ditën aktuale plus periudhën prej 28 ditësh kalendarike të mëparshme, ku në të gjitha rastet shpejtësia e autorizuar e mjetit është kapërcyer. Kjo përcaktohet si të gjitha periudhat prej më shumë se një minutë gjatë së cilës shpejtësia e mjetit kapërcen 90 km/h për mjetet e kategorisë M1, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 47 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës

së Shqipërisë, të ndryshuar.

c) Kur gjykohet e arsyeshme, shpejtësitë e çastit të realizuar nga mjeti dhe të regjistruara nga pajisja e regjistrimit (tahografi) për jo më shumë se 24 orë para përdorimit të mjetit.

d) Funkzionimin korrekt të pajisjes së regjistrimit (përcaktimi i përdorimit të gabuar të mundshëm të pajisjes dhe/ose kartës së drejtuesit të mjetit dhe/ose fletët regjistruese) ose, kur është e përshtatshme, prezenca e dokumenteve të përmendura në pikat 16-18 të kapitullit IV të rregullores për organizimin e kohës së punës së personave, që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit, miratuar me VKM-në nr.1243, datë 10.9.2008 (libri i regjistrimit/udhëtimeve) dhe vërtetimin sipas pikës 32 të kësaj rregulloreje,

e) Instalimin, riparimin, verifikimin, kalibrimin, plumbosjen dhe pajisjen me pllaketë të tahografëve, qofshin analog ose dixhital, të cilat kryhen në përputhje me kapitullin V dhe VI të aneksit, të AETR-së dhe në përputhje me ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”. Në këtë rast, organet e kontrollit në rrugë duhet të kenë parasysh:

i) kalibrimin dhe verifikimin e pajisjes së regjistrimit (tahografi), të cilat kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) ose subjektet e autorizuara prej saj. Ky institucion njofton Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe DPSHTRR-në, e cila njofton organet e kontrollit për subjektet e autorizuar prej saj;

ii) instalimin, riparimin dhe vulosjen, të cilat kryhen nga prodhuesi ose ofiçina e autorizuar nga prodhuesi. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor regjistron në një regjistër të veçantë të dhënat dhe shenjat dalluese që duhet të përdorë çdo ofiçinë e autorizuar. Modeli i regjistrimit për regjistrimin e ofiçinave të autorizuara jepet me udhëzim të ministrit;

iii) verifikimin fillestar e periodik të përcaktuar sipas kushteve të vendosura në marrëveshjen AETR/legjislacionit europian dhe në udhëzimin e ministrit përgjegjës për ekonominë për tipin e miratuar.

Në bazë të pikës 3 të nenit 23 të ligjit 9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, Drejtoria e Përgjithshme Metrologjisë ose subjektet e autorizuara prej saj lëshojnë certifikatën e verifikimit të pajisjes së regjistrimit (tahografit).

f) Mbajtjen regjistrime me dorë nga drejtuesit e mjeteve për rastin e pikës 14 të rregullores, të miratuar me VKM-në nr.1243, datë 10.9.2008 ose nenit 9 të AETR-së.

Në rastin kur, gjatë udhëtimit pajisja e regjistrimit (tahografi) në mjet prishet, keqfunksionon ose kur për shkak të largimit nga mjeti, drejtuesit nuk kanë qenë në gjendje të përdorin pajisjen, ata do të shënojnë me dorë në fletën e regjistrimit duke përdorur simbolet grafike të përshtatshme në përputhje me marrëveshjen AETR/legjislacionit europian, që jepen me udhëzim të ministrit, që i korrespondojnë veprimtarive të tyre që parashikohen në pikat 5 - 9 të rregullores, të miratuar me VKM-në 1243, datë 10.9.2008.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit rrugor njofton organet homologe në shtetet e tjera për të gjithë ofiçinat e autorizuara dhe për subjektet e autorizuara nga DPM, respektivisht me shenjat dalluese, që përdorin ato në vulë, së bashku me adresat e vendndodhjes së tyre.

14. Organet e kontrollit, gjatë kontrollit në anë të rrugës, në përputhje me kërkesat e pikës 13, për mjetet e huaja do të regjistrojnë, me qëllim shkëmbimin e informacionit me shtetet e tjera, elementet si vijon:

- i) shtetin e regjistrimit të mjetit;
- ii) shtetin e regjistrimit të ndërmarrjes;
- iii) origjinën dhe destinacionin e udhëtimit;
- iv) llojin e tahografit: analog ose dixhital.

15. Nëse përfundimet e kontrollit, në anë të rrugës, mbi drejtuesin e mjetit të regjistruar në një shtet tjetër, mbështesin arsyet për të besuar se kanë ndodhur shkelje, të cilat nuk mund të vërtetohen gjatë kontrollit si pasojë e mungesës së të dhënave të nevojshme, organet e kontrollit veprojnë në përputhje me nenin 205 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së

Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe kërkojnë mbështetjen e organeve përkatëse të shtetit tjetër për sqarimin e mëtejshme të situatës.

16. Kontrolli i mjeteve të huaja, të regjistruara në një shtet tjetër, (nuk janë të regjistruara në Shqipëri) kryhet në përputhje me marrëveshjen e AETR-së.

17. Nëpunësit e kontrollit kanë të drejtë të inspektojnë, kopjojnë, marrin dhe ruajnë regjistrimet të cilat mund të zbulojnë shkelje të dispozitave të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodit Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar e të rregullores, të miratuar me VKM-në nr.1243, datë 10.9.2008 dhe, ose AETR-së. Ata, gjithashtu, kanë të drejtë të inspektojnë pajisjen e regjistrimit (tahografët) dhe, nëse ka, pajisjen e cila mund të përdoret në interferimin me pajisjen e tahografit. Në këtë rast, ata kanë të drejtë për të dërguar një mjet të tillë të vendit ku ai mund të inspektohet. Nëse ata kanë arsye të besojnë, që një pajisje interferuese është në përdorim, ose që tahografi ka qenë nën ndikimin e interferencës, nëpunësit e kontrollit mund të heqin tahografin dhe pezullojnë pajisjet për qëllime të inspektimit dhe ta mbajnë atë si provë kur e shohin të arsyeshme.

18. Nëpunësi i kontrollit, kur e gjykon të arsyeshme, gjatë kryerjes së detyrës mund të mbajë një fletë të regjistruar të tahografit, dhe drejtuesi i mjetit duhet t’i kërkojë nëpunësit të firmos fletën zëvendësuese, e cila duhet të futet në tahograf para vazhdimit të udhëtimit, me emrin e nëpunësit të kontrollit, numrin e telefonit dhe numrin e fletës së mbajtur. Në mënyrë alternative, një dokument (vërtetim) duhet t’i jepet drejtuesit të mjetit nga nëpunësi i kontrollit.

19. Kur drejtuesi i mjetit është duke përdorur tahograf dixhital dhe, përjashtimisht, kanë bërë printime kur drejtojnë pa kartë dhe nëpunësi i kontrollit ruan një ose më shumë prej këtyre printimeve, zbatohet i njëjti parim si në paragrafin e mësipërm. Drejtuesi duhet të bëjë printime shtesë që mbulojnë të njëjtën periudhë si printimet e marra nga nëpunësi i kontrollit, i nënshkruan ato dhe detaje të përshtatshme kur është e mundur. Me fletët e ruajtura, i kërkon nëpunësit të firmosë printimet zëvendësuese ose printimet ose të sigurojë një dokument (vërtetim).

Nëpunësit e kontrollit mund të kryejnë printime të të dhënave të magazinuara në kartat e drejtuesit dhe tahografit dixhital dhe mund t’u kërkojë drejtuesve t’i nënshkruajnë ato printime për të konfirmuar që ato janë të vërteta dhe regjistrim i plotë i veprimtarisë së drejtuesit gjatë periudhës përkatëse (ose për të kryer korrektime manuale nëse regjistrimi nuk është korrekt). Të njëjtin veprim nëpunësi i kontrollit duhet të kryejë edhe me fletën e regjistrimit të tahografit analog të regjistruar.

20. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në përputhje të pjesshme edhe me pikën 4 të nenit 12 të AETR-së, e amenduar, në bashkëpunim me organin/organet homologe, respektive të një ose më shumë shteteve të tjera, ushtron jo më pak se gjashtë herë në vit, në të njëjtën kohë, kontrole, secili në territorin e tij, mbi drejtuesin dhe mjetin që përfshihen brenda dispozitave të AETR-së dhe, ose rregullores të miratuar me VKM-në nr.1243, datë 10.9.2008, si dhe funksionimin e pajisjes së regjistrimit (tahografit), për transportuesit, që kryejnë transporte ndërkombëtare.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor informon, shtetet me të cilat janë marrë vesh, lidhur me rezultatet e këtij kontrolli. Informacioni i shkëmbyer do të plotësohet sipas modeleve që përcaktohen në pikën 2.

21. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor planifikon çdo fillim viti kontrollet në anë të rrugës e në zyra, duke venë në dijeni, për këtë, organet e tjera të kontrollit. Gjithashtu, kontrollet në zyra kryhen, nëse shkelje serioze të dispozitave të rregullores të miratuar me VKM-në nr.1243, datë 10.9.2008 dhe rregullores për pajisjet e regjistrimit janë konstatuar në rrugë. Kontrollet në zyra bëhen vetëm nga nëpunës të autorizuar me shkrim nga drejtuesit e tyre.

22. Gjatë kontrollit në zyra, nëpunësit e kontrollit pajisen me:

a) Një listë me elementet kryesore për t’u kontrolluar të treguar në pikën 13 dhe nën-pikave si vijon:

i) periudhat e pushimit javor dhe kohët e drejtimit të mjetit ndërmjet këtyre periudhave të pushimit;

ii) respektimi i kufizimeve dyjavore në kohën e drejtimit të mjetit;

iii) fletët e regjistrimit, njësia e mjetit dhe karta e drejtuesit të mjetit dhe printimet.

Nëse gjykohet e arsyeshme organet përkatëse kontrollojnë mbi përgjegjësitë e përbashkëta të pjesëtarëve të tjerë në zinxhirin e transportit, të tillë si dërguesit, agjentët specionerë ose kontraktorët. Në këtë rast, verifikohen kontratat, nëse e lejojnë transportin të kryhet në përputhje me dispozitat e AETR-së dhe, ose VKM-së nr.1243 datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullores për organizimin e kohës së punës të personave, që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit”.

23. Organet e kontrollit në rrugë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, marrin në konsideratë çdo informacion të siguruar nga organi i kontrollit përkatës në një shtet tjetër, siç përmendet në pikën 25 për sa i përket veprimtarisë së ndërmarrjes, në fjalë, në shtetin tjetër.

24. Në zbatim të dispozitave të pikave 21, 22 dhe 23 kontrollet e kryera në zyrat e organeve të transportit të pranimit (licencimit) ose regjistrimit të transportuesve rrugorë, në bazë të dokumenteve përkatëse ose të dhënave të dorëzuara nga ndërmarrjet, me kërkesë të këtyre organeve, do të kenë vlerë të njëjtë ligjore me kontrollet e kryera në zyrat e ndërmarrjeve.

25. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) është institucioni përgjegjës e përfaqësues për bashkëpunimin në veprimet e ndërmarrja sipas pikës 20, si dhe në zbatim të pikës 15 siguron mbështetjen e organit/organeve homologe, përkatëse të shtetit tjetër.

26. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor publikon çdo dy vjet statistikat, sipas pikës 8, përmes një formulari standard që përcaktohet me udhëzim të ministrit në përputhje me modelin që përdoret nga shtetet anëtare të KE-së.

27. Informacioni i përgatitur nga DPSHTRR-ja do t’u dërgohet rregullisht çdo gjashtë muaj të gjitha shteteve anëtare të KE-së, si dhe rast pas rasti edhe një shteti të vetëm me kërkesën e këtij të fundit, në lidhje me:

a) shkeljet e dispozitave të akteve të përmendura më sipër nga transportues të huaj që nuk janë të regjistruar në Shqipëri (jorezident);

b) dënimet e vendosura nga organet e kontrollit për një transportues shqiptar, për shkeljet që ka kryer në territorin e një shteti tjetër, ose t’i kërkojë shtetit/shteteve informacione në lidhje me shkeljen e dispozitave të AETR-së, për transportuesit jorezident, ose për transportuesit shqiptar.

DPSHTRR-ja në marrëveshje me organet homologe të shteteve anëtare të KE-së, bie dakord për vendosjen e sistemeve të shkëmbimit elektronik të informacionit e për metodologjinë e përbashkët të shkëmbimit efektiv të këtij informacioni.

28. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor bashkëpunon me organet homologe në shtetet anëtare të KE-së për futjen e një sistemi të njëjtë për klasifikimin e rrezikut, bazuar në numrin relativ dhe shkallën e dëmit të çdo shkeljeje të dispozitave të AETR-së dhe, ose rregullores, të miratuar me VKM-në nr.1243, datë 10.9.2008.

29. Ndërmarrjet, që paraqesin një rrezik më të madh për shkak të shkeljeve të konsiderueshme të dispozitave të AETR-së dhe, ose rregullores, të miratuar me VKM-në nr.1243, datë 10.9.2008, do të kontrollohen e vëzhgohen më shpesh e më afër nga organet e kontrollit. Për këto ndërmarrje, DPSHTRR-ja harton një plan të veçantë kontrolli.

30. Për një zbatim më të mirë në praktikë Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR-ja) në bashkëpunim edhe me organet homologe në shtetet anëtare të KE-së dhe, ose institucionet ndërkombëtare të interesuara nxjerr udhëzime, mbi praktikën më të mirë të kontrollit në zbatim të VKM-së nr.1243, datë 10.9.2008 dhe ose AETR-së, si dhe i publikon ato çdo dy vjet.

31. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në bashkëpunim ose jo, me organet homologe të shteteve të tjera, organizon jo më pak se një herë në vit programe trajnimi për nëpunësit e organeve të kontrollit në rrugë, lidhur me instruksionet mbi praktikën më të mirë të kontrolleve.

Përmes marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, DPSHTRR-ja shkëmben me shtete të tjera të dhënat dhe eksperiencën për kontrollin në këtë fushë.

32. Një vërtetim që mbulon disa veprimtari të tjera gjatë periudhës, në të cilën përfshihet dita aktuale plus 28 ditë të mëparshme lëshohet nga punëdhënësi për t'u përdorur nga drejtuesi i mjetit, kur ky:

a) ka qenë me raport mjekësor,

b) ka qenë me leje pushimi vjetore:

c) ka drejtuar një mjet të përjashtuar nga fusha e zbatimit të AETR-së dhe, ose rregullores, të miratuar me VKM-në nr.1243, datë 10.9.2008.

Modeli i këtij vërtetimi përcaktohet me udhëzim të ministrit në përputhje me dokumentin standard që përdorin shtetet anëtare të KE-së.

Megjithatë, vërtetimi nuk kërkohet, nëse regjistrimet e tahografit tregojnë drejtimin e mjetit jashtë fushës së zbatimit të AETR-së dhe, ose rregullores, të miratuar me VKM-në nr.1243, datë 10.9.2008. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit rrugor njofton shtetet anëtare të KE-së, që përdorimi i vërtetimit është i detyrueshëm.

33. Mjetet e regjistruara për herë të parë pas datës 1 maj 2006, të cilat përfshihen në fushën e zbatimit të AETR-së dhe, ose rregullores të miratuar me VKM-në nr.1243, datë 10.9.2008, krahas tahografit dixhital duhet të jenë pajisur edhe me tahograf analog deri në plotësimin e dispozitave të pikës 34.2, të rregullores, të miratuar me VKM-në nr.1243, datë 10.9.2008.

34. Për mjetet e përshtatshme për udhëtarë me nëntë persona përfshirë edhe drejtuesin e mjetit, të licencuar në shërbimin taksi, sipas shkronjës "c" dhe "ç" të pikës 2.1 të rregullores për organizimin e kohës së punës së personave, që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit, miratuar me VKM-në nr.1243, datë 10.9.2008, rregullorja do të zbatohet 12 muaj pas hyrjes në fuqi.

ANEKSI I

PJESA A

REGJISTRIMET QË DUHET TË MBAHEN NGA DREJTUESI I MJETIT DHE PUNËDHËNËSI

Drejtuesit e mjeteve që përdorin tahograf analogë duhet të mbartin në mjet të gjitha fletët e tahografit (jo fotokopje) për ditën aktuale plus 28 ditë kalendarike të mëparshme. Në mjet mbarten të gjitha fletët e regjistruara, pavarësisht, nëse mjeti që ata përdorin është i pajisur me tahograf analog ose dixhital.

Drejtuesi i mjetit duhet t'i kthejë këto fletë te punëdhënësi i tij brenda 42 ditëve kalendarike.

Punëdhënësi:

a) duhet të sigurohet që drejtuesit dorëzojnë fletët e tyre të regjistrimit të tahografit brenda 42 ditëve;

b) duhet të mbajë të gjitha regjistrimet jo më pak se 1 (një) vit, nga data e regjistrimit të fundit;

c) duhet të kryejë kontrole të rregullta, nëse rregullat për orët e drejtimit të mjeteve sipas AETR-së dhe, ose rregullores, të miratuar me VKM-në nr.1243, datë 10.9.2008 janë zbatuar; nëse ato janë shkelur, duhet të sigurohen që të mos ndodhin përsëri; dhe

d) duhet të jenë të gatshëm t'u paraqesin organeve të kontrollit fletët e tahografit të regjistruara të paktën të një 1 viti, nga data e regjistrimit të fundit.

Punëdhënësit dhe drejtuesit e mjeteve duhet t'u paraqesin fletët e tahografit organeve të kontrollit kur kërkohen prej tyre.

Drejtuesit e mjeteve, që janë të pajisur me një kartë tahografi të drejtuesit të mjetit, duhet të kenë të disponueshme për kontroll të gjitha printimet që ata kanë bërë gjatë javës aktuale dhe 21 ditët kalendarike të mëparshme, në të gjitha rastet, kur ata janë duke kryer detyrën e drejtimit, që

përfshin kohët kur ata janë duke përdorur një mjet të pajisur me një tahograf analog. Nëse, drejtuesi i mjetit, nuk ka me vete kartën e tij të përdorshme gjatë një kontrolli në rrugë, atij i vendoset gjobë në bazë të legjislacionit në fuqi.

Punëdhënësit duhet të mbajnë dokumentet përkatëse e të përkohshme (d.m.th. printimet, certifikatat e patransferueshme elektronikisht ose dokumentet e tjera të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë etj.) në përputhje me pikën 10 (jo më pak se 1 vit nga data e regjistrimit të fundit) dhe certifikatën sipas paragrafit të dytë të pikës “ii” të shkronjës “e” të pikës 13, në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 24 të ligjit “Për metrologjinë”.

Drejtuesit e mjeteve duhet të mbajnë me vete fletë regjistrimi në përdorimin e tahografit analog ose fletë printimi për tahografin dixhital aq sa drejtuesi i veprimtarisë së ndërmarrjes i konsideron të mjaftueshme për t’u përdorur për më shumë se 30 ditë udhëtim.

ANEKSI I

PJESA B

LIBRI I REGJISTRIMEVE QË DUHET TË MBAHET NGA DREJTUESI I MJETIT DHE PUNËDHËNËSI

Librat e regjistrimeve përdoren kur rregullat e veçanta zbatohen te shumica e mjeteve që janë të përjashtuar nga rregullat e pikave 6-10 të rregullores, të miratuar me VKM-në nr.1243, datë 10.9.2008.

Drejtuesit e mjeteve që përdorin librin e regjistrimit duhet të mbartin në mjet të gjitha fletët e librit për ditën aktuale plus 28 ditë kalendarike të mëparshme.

Drejtuesi i mjetit duhet të kthejë librin e regjistrimit te punëdhënësi i tij brenda 42 ditëve kalendarike.

Punëdhënësi:

e) duhet të sigurohet që drejtuesit dorëzojnë fletët e librit të regjistrimit brenda 42 ditëve;

f) duhet të mbajë të gjitha regjistrimet jo më pak se 1 (një) vit nga data e regjistrimit të fundit;

g) duhet të kryejë kontrolle të rregullta nëse rregullat për orët e punës, nëse ato janë shkelur duhet të sigurohen që të mos ndodhin përsëri; dhe

h) duhet të jenë të gatshëm t’i paraqesin organeve të kontrollit të gjitha regjistrimet të paktën të një 1 viti nga data e regjistrimit të fundit.

Punëdhënësit dhe drejtuesit e mjeteve duhet t’u paraqesin librin ose fletët e regjistrimit organeve të kontrollit kur kërkohen prej tyre.

VENDIM

Nr.217, datë 2.2.2009

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, TË NJË PJESE TË NDËRTESESË SË ISH-MINISTRISË SË TRANSPORTEVE E TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të katit të parë teknik në ndërtesën e ish-Ministrisë së Transporteve e Telekomunikacioneve, sipas vendndodhjes, të përcaktuar në planimetrinë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Brendshme dhe Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.219, datë 6.3.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1703, DATË 24.12.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR VENDOSJEN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE DHE TË
VEPRIMTARIVE SEZONALE/TË PËRKOSSHME, PËR MINISTRITË DHE
INSTITUCIONET BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 4 e vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.220, datë 6.3.2009

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE MËSIMORË, ME KONTRATË TË
PËRKOSSHME, PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2009, PËR MINISTRINË E
ARSIMIT DHE SHKENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve mësimorë, me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, për periudhën janar-qershor 2009, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, të jetë 3 061 veta.

2. Të dhënat për numrin dhe afatin kohor të kontraktimit të punonjësve mësimorë, me kontratë të përkohshme, janë sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NUMRI I PUNONJËSVE MËSIMORË ME KONTRATË TË PËRKOJSHME NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR PËR PERIUDHËN 1 JANAR 30 QERSHOR 2009

Nr.	EMËRTIMI	1 janar 1 korrik 2009
I	Berat	106
a	Arsimi bazë 0.42	96
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	4
c	Arsim i mesëm profes. 0.44	5
d	Ars.mes.prof.komb. 0.44	1
I	Skrapar	31
a	Arsimi bazë 0.42	25
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	3
c	Arsim i mesëm profes. 0.44	3
I	Kuçovë	14
a	Arsimi bazë 0.42	9
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	2
c	Arsim i mesëm profes. 0.44	3
I	Durrës	180
a	Arsimi bazë 0.42	173
b	Arsim i mesëm 0.43	1
d	Ars.mes.prof.komb. 0.44	6
	Sh. "B.Cela"	2
	Sh."B.Qeraxhi"	4
I	Krujë	54
a	Arsimi bazë 0.42	53
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	1
I	Dibër	83
a	Arsimi bazë 0.42	69
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	10
c	Arsim i mesëm profes. 0.44	4
I	Bulqizë	26
a	Arsimi bazë 0.42	21
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	5
I	Mat	107
a	Arsimi baze 0.42	95
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	11
c	Arsim i mesëm profes. 0.44	1
I	Elbasan	209
a	Arsimi baze 0.42	179
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	16
c	Arsim i mesëm profes. 0.44	10
d	Ars.mes.prof.komb. 0.44	4

	Sh. "Luigj Gurakuqi"	1
	Ah. "Ali Myftiu"	3
I	Gramsh	33
a	Arsimi bazë 0.42	28
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	5
I	Librazhd	60
a	Arsimi bazë 0.42	60
I	Peqin	51
a	Arsimi bazë 0.42	50
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	1
I	Fier	197
a	Arsimi bazë 0.42	187
b	Arsim i mesëm 0.43	5
d	Ars.mes.prof.komb. 0.44	5
	Sh.Artistike "Jakov Xoxa"	5
I	Mallakastër	31
a	Arsimi bazë 0.42	31
I	Lushnjë	77
a	Arsimi bazë 0.42	62
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	10
c	Arsim i mesëm profes. 0.44	5
I	Gjirokastër	34
a	Arsimi bazë 0.42	27
c	Arsim i mesëm profes. 0.44	7
I	Përmet	17
a	Arsimi bazë 0.42	12
b	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	5
I	Tepelenë	37
a	Arsimi bazë 0.42	36
b	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	1
I	Korçë	81
a	Arsimi bazë 0.42	75
c	Arsim i mesëm profes. 0.44	6
I	Kolonjë	6
a	Arsimi bazë 0.42	5
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	1
I	Zyra arsimore Devoll	12
a	Arsimi bazë 0.42	10
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	2
I	Pogradec	47
a	Arsimi bazë 0.42	46
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	1
I	Kukës	64
a	Arsimi bazë 0.42	60
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	4

I	Has	57
a	Arsimi bazë 0.42	55
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	2
I	Tropojë	54
a	Arsimi bazë 0.42	47
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	7
I	Lezhë	86
a	Arsimi bazë 0.42	71
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	15
I	Laç	63
a	Arsimi bazë 0.42	58
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	5
I	Mirditë	66
a	Arsimi bazë 0.42	66
I	Shkodër	241
a	Arsimi bazë 0.42	199
b	Arsim i mesëm 0.43	23
c	Arsim i mesëm profes. 0.44	7
d	Ars.mes.prof.komb. 0.44	12
	Sh.Industriale “Arben Broci”	4
	Sh.Pyjore “Kol Margjini”	4
	Sh.Artistike “Preng Jakova”	4
I	Pukë	13
a	Arsimi bazë 0.42	10
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	3
I	Malësi e Madhe	39
a	Arsimi bazë 0.42	37
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	2
I	Kavajë	31
a	Arsimi bazë 0.42	26
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	5
I	Bashkia Tiranë	557
a	Arsimi bazë 0.42	263
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	167
d	Ars.mes.prof.komb. 0.44	127
1	Shkolla e mesme “J.Misja”	67
2	Shkolla e mesme Hoteleri Turizëm	7
3	Shkolla e mesme koreografike	8
4	Shkolla e mesme “L.Boriçi”	2
5	Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja	13
6	Shkolla e mesme ekonomike	13
7	Shkolla e mesme e ndërtimit	8
8	Shkolla e mesme teknike	9
III	Tirana rreth	134
a	Arsimi bazë 0.42	105

b	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	29
I	Vlorë	87
a	Arsimi bazë	73
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm	10
c	Arsim i mesëm profes.	2
d	Ars.mes.prof.komb.	2
	Sh.”Industriale “Pavarësia”	2
I	Sarandë	56
a	Arsimi bazë	52
c	Arsim i mesëm profes.	4
I	Delvinë	20
a	Arsimi bazë	19
b	Arsim i mesëm i përgjithshëm	1
A	Arsimi parauniversitar	3061
1	Arsimi bazë 0.42	2490
2	Arsim i mesëm i përgjithshëm 0.43	357
3	Arsim i mesëm profes. 0.44	57
4	Ars.mes.prof.komb.	157

VENDIM
Nr.239, datë 21.1.2009

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT AFATMESËM EKONOMIK DHE FISKAL, TË SHQIPËRISË, 2008-2011

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit afatmesëm ekonomik dhe fiskal të Shqipërisë, 2008-2011, sipas tekstit dhe relacionit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.251, datë 12.3.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË NDRYSHUAR, NDËRMJET ALBPETROL, SHA-SË, DHE BANKERS PETROLEUM ALBANIA, LTD, PËR MARRËVESHJEN HIDROKARBURE, TË DATËS 19 QERSHOR 2004, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.477, DATË 16.7.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE, NË VENDBURIMIN E PATOS-MARINZËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së ndryshuar, ndërmjet Albpetrol, sh.a.-së dhe Bankers Petroleum Albania, Ltd, për marrëveshjen hidrokarbure, të datës 19 qershor 2004, miratuar me vendimin nr.477, datë 16.7.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në vendburimin e Patos-Marinzës”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

E NDRYSHUAR, ALBPETROL SHA DHE BANKERS PETROLEUM LTD NË LIDHJE ME MARRËVESHJEN HIDROKARBURE, DATË 19 QERSHOR 2004 PËR ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN NË FUSHËN E PATOS-MARINZËS ALBANIA

Kjo shtesë e marrëveshjes (të cilës prej këtu në vazhdim do t'i referohemi si marrëveshja) është bërë dhe ka hyrë në fuqi nga data 8 dhjetor 2008 me pjesëmarrjen e Albpetrol sh.a. (Albpetrol) dhe Bankers Petroleum Albania Ltd (që këtu e në vazhdim do t'i referohemi me përcaktimin “Kontraktori”), që këtu e në vazhdim do të përmenden me përcaktimin palët.

*Duke pasur parasys*h që marrëveshja e hidrokarbure e datës 19 qershor 2004 (që prej këtu e në vazhdim do t'i referohemi marrëveshja hidrokarbure) është përgatitur nga dhe me pjesëmarrjen e palëve Saxon International Energy Ltd (tani Bankers Petroleum Albania Ltd) dhe Albpetrolit, marrëveshje kjo e aprovuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me vendim numër 477 të datës 16 korrik 2004;

*duke pasur parasys*h që marrëveshja hidrokarbure lidhet me licencë-marrëveshjen (licencë marrëveshje) për zhvillimin dhe prodhimin hidrokarbure në fushën naftëmbajtëse të Patos Marinzës të datës 7 qershor 2004 e firmosur nga Ministria e Industrisë dhe Energjetikës e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve dhe Albpetrol sh.a.;

*duke pasur parasys*h që qeveria aprovoi ligjin nr.9975, datë 28 korrik 2008, i cili trajton çështjen e rentës minerare e cila duhet të paguhet nga kontraktori që merret me prodhimin e hidrokarbureve në territorin e Republikës së Shqipërisë;

duke pasur parasysh që Kontraktori ka të drejtën ekskluzive të zhvillojë operacione hidrokarbure dhe të prodhojë naftë në zonën e kontratës, zonë kjo e përshkruar në marrëveshjen hidrokarbure dhe në licencë –marrëveshjen;

duke pasur parasysh që palët e dinë që për prodhimin, përpunimin dhe depozitimin e hidrokarbureve do të duhen investime të konsiderueshme dhe;

duke pasur parasysh që palët e dinë që aprovimi i planit të zhvillimit për zbulime të tilla nafte kushtëzohet nga rënia dakord në unanimitet e palëve; dhe

duke pasur parasysh që palët e dinë që implementimi i rentës minerare kërkon ndryshimin e marrëveshjes hidrokarbure sipas nenit 18.3 dhe në përputhje me nenin 5 paragrafi 3d të ligjit nr.7746 “Për hidrokarburet”, me qëllim ruajtjen e ekuilibrit ekonomik të marrëveshjes hidrokarbure,

që tani e në vazhdim, duke marrë në konsideratë kushtet paraprake dhe marrëveshjet dypalëshe reciproke që përmban ky dokument, palët këtu bien dakord për të amenduar disa nga dispozitat e nenit 1, nenit 9 dhe nenit 13.2 dhe nenit 2.10 (shtojca B) të marrëveshjes hidrokarbure, për zhvillimin dhe prodhimin në fushën e Patos-Marinzës.

Neni 1

Objekti

1.1 Kjo Marrëveshje, së bashku me marrëveshjen hidrokarbure, jep detaje të kushteve dhe afateve që rregullojnë operacionet hidrokarbure në zonën e kontratës ose në çdo pjesë tjetër të përcaktuar në marrëveshjen hidrokarbure, dhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky dokument dhe marrëveshjes hidrokarbure.

1.2 Palët e njohin dhe bien dakord që të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me hidrokarburet do të kontrollohen nga dispozitat e marrëveshjes hidrokarbure të amenduara me këtë marrëveshje.

1.3 Të gjitha dispozitat e marrëveshjes hidrokarbure të amenduara në këtë marrëveshje janë ratifikuar dhe miratuar dhe kanë hyrë dhe mbeten në fuqi. Kuptohet që në rast të ndonjë mospërputhjeje me marrëveshjen hidrokarbure, dispozitat e kësaj marrëveshjeje janë ato që do të merren për bazë dhe do të zëvendësojnë dispozitat e marrëveshjes hidrokarbure.

1.4 Referencat për paragrafët e marrëveshjes hidrokarbure janë bërë duke marrë parasysh tekstin e marrëveshjes hidrokarbure të datës 19 qershor 2004.

Neni 2

Përcaktimet

Termet dhe përcaktimet e përdorura në këtë marrëveshje do të kenë të njëjtin kuptim, ashtu sikundër dhe janë të specifikuara në marrëveshjen hidrokarbure, të cilat do të amendohen duke përfshirë shtesat dhe amendimet e mëposhtme:

1.6 A AKBN do të thotë Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. E themeluar nga qeveria shqiptare dhe përgjegjëse për vënien në zbatim të ligjit të hidrokarbureve, ashtu sikundër edhe përcaktohet nga vendimi nr.547, datë 9 gusht 2006 i aprovuar nga Këshilli i Ministrave.

1.54 Do të amendohen duke fshirë fjalën e fundit të fjalisë “taksat” dhe duke e zëvendësuar atë me “Tatimi mbi fitimin ashtu sikundër e parashikon neni 13 i kësaj marrëveshjeje” me qëllim që të sigurohet përputhja me nenin 13 të marrëveshjes hidrokarbure dhe nenin 2.10 të shtojcës B.

1.6 B “Pjesa e AKBN-së” ka kuptimin e dhënë në nenin 9.2.

1.56 A “Renta minerare” ka kuptimin e dhënë në nenin 9.2

Neni 3
Neni 9 i marrëveshjes hidrokarbure

3.1 Titulli i neni 9 të marrëveshjes hidrokarbure është amenduar si më poshtë:

Neni 9
Renta minerare, pjesa e Albetrolit, pjesa e AKBN-së dhe mbulimi i shpenzimeve

3.2 Neni 9.2 i marrëveshjes hidrokarbure është amenduar si më poshtë:

9.2 Nafta gjendje do të matet në pikën e peshimit dhe do të ndahet siç parashikohet në këtë marrëveshje. Nafta gjendje do të ndahet midis qeverisë (“Renta minerare”) Albetrolit (“Pjesa e Albetrolit”), AKBN-së (“Pjesa e AKBN-së”) dhe Kontraktorit (“Mbulimi i shpenzimeve hidrokarbure”) ashtu siç edhe është e shpjeguar në tabelën që vijon:

Periudha	Faktori R	Renta minerare	Pjesa e Albetrolit	Pjesa e AKBN	Mbulimi i kostove hidrokarbure
1 prill 2008 – 19 gusht 2008	$R < 1.0$	0%	1%	9%	90%
20 gusht 2008 – përfundim i marrëveshjes	$R < 1.0$	10%	1%	0%	89%
	$1.0 \leq R < 1.5$	10%	3%	0%	87%
	$1.5 \leq R < 2.5$	10%	4%	0%	86%
	$R \geq 2$	10%	5%	0%	85%

Renta minerare do të paguhet në para zyrës përkatëse të taksave apo doganës, në përputhje me ligjin shqiptar.

Pjesa e Albetrolit do të merret në naftë dhe do t’u jepet në natyrë në zonën e kontratës në impiantin qendror të trajtimit të kontraktorit (CTF) ose në çdo vend tjetër brenda zonës së kontratës me marrëveshje reciproke midis palëve.

Pjesa e AKBN-së do të paguhet në para në një institucion të përshtatshëm të qeverisë shqiptare, gjë kjo që do të vendoset nga AKBN-ja. Data e fillimit të llogaritjeve të pjesës së AKBN-së do të jetë 1 prilli i vitit 2008 dhe do t’i paguhet një institucioni të përshtatshëm të qeverisë shqiptare vetëm në datën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Një sasi e barabartë me pjesën e rentës minerare e paguar kjo me para qeverisë shqiptare do të përfshihet në kostot hidrokarbure si më poshtë:

Ku:

$0 \leq R < 1.0$ 10% të vlerës së rentës minerare
 $R \geq 1$ 100% të vlerës së rentës minerare

Faktori R do të llogaritet si më poshtë:

$$R_K = \frac{A_N}{B_K}$$

ku:

RK është faktori R për tremujorin kalendarik N.

AK është shuma e të ardhurave të kontraktorit minus taksën e fitimit hidrokarbure gjatë tremujorit kalendarik N dhe të gjithë tremujorëve të tjerë kalendarikë paraardhës që vijnë mbas datës efektive.

BK është shumë e kostove hidrokarbure në tremujorin kalendarin N dhe në të gjithë tremujorët e tjerë paraardhës që vijnë mbas datës efektive, duke lënë jashtë atë pjesë të taksës minerare, që është përfshirë në koston hidrokarbure.

Çdo ripërshtatje në gëzimin e të drejtave për tremujorin e tanishëm kalendarik do të shpërndahet mbi pjesën e mbetur të vitit të tanishëm fiskal me qëllim që pala që gëzon të drejtën e të pasurit sasi shtesë hidrokarbure gjendje për tremujorin e tanishëm kalendarik, ta marrë këtë sasi në pjesë të përmuajshme si shtesë të sasisë që i takon. Nëse do të ketë muaj kur prodhimi do të jetë i pamjaftueshëm për të përballuar sasinë e ripërshtatur, atëherë të drejtat për të marrë sasinë e pafurnizuar do të shpërndahen në mënyrë të barabartë në muajt e mbetur të tremujorit të tanishëm kalendarik.

Përcaktimi i faktorit R fillimisht do të bëhet për tremujorin e parë mbas datës efektive.

Neni 4

Neni 13 i marrëveshjes hidrokarbure

4.1 Neni 13.2 i marrëveshjes hidrokarbure amendohet si më poshtë:

13.2 Përveç taksave dhe detyrimeve të parashtruara në nenin 13.1 dhe 14.1 dhe rentës minerare, pjesës së AKBN-së dhe pjesës së Albpetroilit të parashikuar në nenin 9.2, kontraktori dhe bashkëpunëtorët e tij përkatës. Nënkontraktorët dhe personeli i huaj përjashtohen nga taksat dhe detyrimet që kanë lidhje me operacionet hidrokarbure, të parashikuara nga ligji shqiptar. Ky përjashtim nuk përfshin tarifat portuale, ato të magazinimit dhe ato postare, si dhe tarifa të ngjashme doganore të karakterit të përgjithshëm ose për kryerjen e shërbimeve të veçanta. Një pjesë e barabartë me pjesën e rentës minerare do të përfshihet në kostot hidrokarbure, siç është parashikuar në nenin 9.2 dhe nenin 2.10 të shtojcës B.

Neni 5

Shtojca B, neni 2.10 i marrëveshjes hidrokarbure

Neni 2.10 i shtojcës B të marrëveshjes hidrokarbure është amenduar si më poshtë:

2.10 Taksat

Të gjitha taksat dhe detyrimet duke përfshirë dhe një pjesë të rentës minerare, siç është parashikuar nga neni 9.2 i marrëveshjes hidrokarbure, të paguara në Republikën e Shqipërisë nga Kontraktori në përputhje me këtë marrëveshje, përveç tatimit mbi fitimin i cili mbulohet nga neni 13.1 i marrëveshjes hidrokarbure, në qoftë se ka, dhe pjesës së Albpetroilit dhe pjesës së AKBN-së të përcaktuar në nenin 9.2 të marrëveshjes hidrokarbure.

Për sqarime të mëtejshme një sasi e barabartë me 10% të vlerës së rentës minerare, e cila paguhet kur faktori R ashtu sikundër është përcaktuar në nenin 9.2 të marrëveshjes hidrokarbure është më i vogël se 1.0 dhe 100% të vlerës së rentës minerare kur faktori R është i barabartë ose më i madh se 1.0 do të përfshihet në kostot hidrokarbure, pavarësisht se renta minerare zbritet kur përcaktohet mbulimi i kostove hidrokarbureve ashtu sikundër parashikohet nga neni 9.2 i marrëveshjes hidrokarbure. Përfshirja e vlerës e barabartë me vlerën e rentës minerare ose të një pjese të saj si kosto hidrokarbure lehtëson impaktin negativ të implementimit të rentës minerare.

Për sqarim të mëtejshëm këtu do të gjeni një shembull për trajtimin e rentës minerare, kur faktori R është $1.0 \leq R < 1.5$.

Shembull llogaritjeje për një shitje prej 1 000 dollarësh

Për	$R < 1.0$	Për $1.0 \leq R < 1.5$
E ardhura bruto	\$1000	\$1000
(E ardhura nga shitjet pa PEP dhe kosto diluenti)		

Renta minerare @10%	100	100
Albpetrol Share @1%, 3%	10	30
Mbulimi i kostove hidrokarbure	890	870
Minus:		
Kostot e mbulueshme (nuk përfshihet vlera e pjesës së rentës minerare)	880	500
Vlera e paguar e rentës minerare (Pjesa siç përcaktohet në nenin 9.2)	10	100
Të ardhurat për tatim (nafta fitim)	0	270
Tatim fitimi@50%	0	135
Kjo rezulton në shpërndarjen e të ardhurës bruto si më poshtë:		
Qeveria shqiptare	\$100	\$235
Albpetrol	10	30
Bankers	890	735
Total	\$1000	\$1000

Prej këtu dëshmojmë që palët kanë planifikuar që kjo marrëveshje të hyjë në fuqi me t'u aprovuar nga Këshilli i Ministrave.

VENDIM
Nr.258, datë 12.3.2009

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 1.12.2008, PËR ÇËSHTJEN “XHERAJ KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të konventës europiane “Për të drejtat e njeriut”, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e konventës europiane “Për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore””, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të datës 1.12.2008, për çështjen nr.37959/02 “Xheraj kundër Shqipërisë”, në shumën 2000 (dy mijë) euro.
2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 25 mars 2009.
3. Detyrimi financiar i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
4. Shuma e përcaktuar, si detyrim, në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në njërin nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit Arben Xheraj dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën, kur do të çelet llogaria.
5. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuesit, nga Ministria e Financave, të bëhet pas paraqitjes të të gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.265, datë 12.3.2009

PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.343, DATË 27.3.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E BURIMEVE DHE TË PROCEDURAVE TË FINANCIMIT TË DËMEVE PASURORE, TË SHKAKTUARA NGA AKSIDENTI TEKNOLOGJIK I GËRDECIT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.343, datë 27.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 1 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje “...dhe në vendimin nr.120, datë 14.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.817, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerës së dëmeve, të shkaktuara në objektet, pronë private, si rrjedhojë e aksidentit teknologjik, të ndodhur në Gërdec, dhe të listave me emrat e individëve dhe personave fizikë e juridikë, që do të kompensohen, si rezultat i procesit të vlerësimit dhe të rivlerësimit”, në vlerën 26 093 453 (njëzet e gjashtë milionë e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e tre) lekë, të debitorëve, të rezultuar nga procesi i rivlerësimit, me vendimin nr.817, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave, sipas tabelës përmbledhëse të rivlerësimeve.”.

2. Në pikën 2 të bëhen këto ndryshime:

i) në paragrafin e parë, shifra “...1572 milionë lekë...”, zëvendësohet me 2 619 192 273 (dy miliardë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

ii) Shifra “...150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë...”, e përmendur në shkronjën “a”, zëvendësohet me “... 481 093 210 (katërqind e tetëdhjetë e një milionë e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e dhjetë) lekë...”.

iii) Në shkronjën “b”, pas fjalëve “...Këshillit të Ministrave...” shtohen “...për vitin 2008...”

iv) Në shkronjën “c”, pas fjalëve “... i kontingjencës...” shtohen “... i vitit 2008...”

v) pas shkronjës “d” shtohen shkronjat “dh” e “e”, me këtë përmbajtje:

“dh) Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për vitin 2009, në masën 99 198 651 (nëntëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekë.

e) Ngarkohet bashkia Vorë të ndjekë procedurat ligjore dhe të arkëtojë shumën 26 093 453 (njëzet e gjashtë milionë e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e tre) lekë, (debitorët e rezultuar nga rivlerësimi), për llogari të Buxhetit të Shtetit.”.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.268, datë 18.3.2009

PËR FINANCIMIN E VEPRIMTARIVE FESTIVE “SHQIPËRIA NË NATO”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin e veprimtarive festive “Shqipëria në NATO”, në vlerën 120 000 000 (njëqind e njëzet milionë) lekë, sipas projektit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
 3. Ndjekja e procedurave dhe lidhja e kontratës për realizimin e këtij projekti të kryhen nga Kryeministria, ndërsa pagesat të kryhen nga Ministria e Mbrojtjes, në përputhje me faturat e autorizuara nga grupi ndërinstitucional i punës, i ngarkuar me organizimin e ceremonialit dhe të të gjitha veprimtarive festive, që do të mbahen me këtë rast.
 4. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.273, datë 18.3.2009

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR TË NDËRTESESË “PREFEKTURA SHKODËR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës e të neneve 3, shkronja “k”, 5 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7867, datë 12.10.1991 “Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të bashkisë së Shkodrës të ndërtesës “Prefektura Shkodër”, sipas formularit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Bashkisë së Shkodrës i ndalohet tjetërsimi ose ndërrimi i destinacionit të pronës, të përcaktuar në këtë vendim. Ajo është institucioni përgjegjës, për ruajtjen e tërësisë së vlerave,
- 24

kulturore e historike, si monument kulture, të kësaj ndërtese, sipas akteve ligjore e nënligjore, në fuqi.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i bashkisë Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

4. Dispozitat e akteve nënligjore, që bien në kundërshtim me pikën 1 të këtij vendimi, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE (Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia SHKODËR		Identifikoi: Ndret Qehaja Specialiste topografe (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)										
		Supervizori: Kujtim Domnori Specialist inxhinier (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)										
Fusha e perdorimit te Prones: <u>Administrative</u>		Apo/voli: Artan Haxhi Kryetar Bashkie Tel 02243720 (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)										
		C										
Nr. Rend.	Zona Kadastrale & Indeksi Hartes	A			B			C			Te dhena tjera (Shenime te vecanta)	
		Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena tjera (Shenime te vecanta)		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11		
26	8594 M-7	3/160	Nd. Truall	Dega e Bankes se Shqiperise Shkoder	519	292	Dega e Bankes Qendrore	Banka e Shqiperise	Banka e Shqiperise	Prese e kait perdhene godinen e Prefektures		
27	8594 M-7	3/270	Nd. Truall	Garazh i deges se B.Sh. Shkoder	117	117	Garazh automjeti	Banka e Shqiperise	Banka e Shqiperise	Ndertese nje kateshe		
28	8591 N-6	1/397+1-1	Nd. Truall	Sherbimi Kombetar i Punesimit (Zyra Punes)	466	466	Zyra pune	Ministria e Punes e ceshnjeve soc	Ministria e Punes e ceshnjeve soc			
29	8591 N-6	1/397+1-3	Nd. Truall	Sherbimi Kombetar i Punesimit (Qendra Formimit Profesional)	557	557	Zyra pune	Ministria e Punes e ceshnjeve soc	Ministria e Punes e ceshnjeve soc			
30	8594 N-7 M-7	3/160 3/237,3/234 3/235,3/269	Nd. Truall	Prefektura+salla e mbledhjeve+ garazh	5584	2094	Zyra pune	Prefektura	Prefektura	Kati I-re Agj. Trajt. Krievive, Kati II-te AKP, Drejt. Aisimore, Pol. Nderit, Enti Banesave, AITPP Kati III-te Prefektura, Kesh. Qarkut Dega Buxhelli		

VENDIM
Nr.274, datë 18.3.2009

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS, PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR
KRIMIT, VEÇANËRISHT TERRORIZMIT, TRAFIKIMIT TË PALIGJSHËM TË
DROGAVE DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogave dhe krimit të organizuar, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS MBI BASHKËPUNIMIN
NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT, VEÇANËRISHT TERRORIZMIT, TRAFIKIMIT TË
PALIGJSHËM TË DROGAVE DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

PARATHËNIE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, në vijim të quajtura si “Palët”,

duke shprehur vullnetin e tyre për të forcuar dhe përmirësuar marrëdhëniet miqësore tashmë ekzistuese dhe bashkëpunuese ndërmjet dy shteteve,

duke shprehur shqetësimin rreth rrezikut të përhapjes së krimit të organizuar ndërkombëtar, trafikimit ndërkombëtar të paligjshëm të drogave narkotike, lëndëve psikotrope dhe prekursorëve, si edhe të terrorizmit,

duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare dhe legjisacionin ekzistues në të dyja shtetet dhe pa cenuar angazhimet e tyre të mëparshme, bazuar në marrëveshjen dypalëshe dhe shumëpalëshe me vendet e treta,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Palët do të bashkëpunojnë dhe do të japin asistencë reciproke në fushat e mëposhtme:

- a) Lufta kundër terrorizmit;
- b) Lufta kundër krimit të organizuar;

- c) Lufta kundër kultivimit të paligjshëm, prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;
 - d) Lufta kundër aktiviteteve të paligjshme në lidhje me armët, përfshirë armët biologjike, kimike dhe radiologjike, municionin, lëndët plasëse, materialin bërthamor dhe radioaktiv, si dhe lëndët helmuese;
 - e) Lufta kundër kontrabandës dhe aktiviteteve të paligjshme financiare ndërkombëtare dhe legalizimi i të ardhurave (pastrimi i parave) që rrjedhin nga aktivitete kriminale;
 - f) Lufta kundër imigrimit të paligjshëm dhe trafikimit të paligjshëm të qenieve njerëzore;
 - g) Lufta kundër falsifikimit dhe tjetërsimit të çdo lloj dokumenti;
 - h) Lufta kundër tjetërsimit dhe falsifikimit të kartëmonedhave, si edhe të monedhave, kartave të kreditit, letrave me vlerë dhe dokumenteve të tjera me vlerë;
 - i) Lufta kundër krimit ndaj personit, shëndetit, lirisë dhe integritetit gjinor;
 - j) Lufta kundër krimit ndaj pronës dhe veçanërisht vjedhjes dhe trafikimit të paligjshëm të mjeteve;
 - k) Kërkimi për persona të zhdukur dhe persona që kanë kryer krime brenda territorit të palës tjetër, si edhe identifikimi i kufomave;
 - l) Lufta kundër trafikimit të paligjshëm të veprave të trashëgimisë historike dhe kulturore, gurëve dhe metaleve të çmuara, si edhe sendeve të tjera me vlerë;
 - m) Përmirësimi i metodave dhe mjeteve për të ruajtur dhe rikthyer rendin publik dhe menaxhimi i situatave me kriza, të tilla si rrëmbimi i avionëve, rrëmbimi i personave etj.;
 - n) Lufta kundër krimit kompjuterik;
 - o) Bashkëpunimi në fusha kulturore, sportive dhe sociale nëpërmjet shkëmbimit të delegacioneve policore;
 - p) Mbrojtja e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.
- Palët do të bashkëpunojnë edhe në fusha të tjera që kanë të bëjnë me kriminalitetin në përgjithësi, parandalimin e krimit dhe ruajtjen e rendit publik, nëse ekziston interesi reciprok.

Neni 2

Bashkëpunimi ndërmjet dy palëve në fushat e përmendura më lart në nenin 1 do të arrihet nëpërmjet:

- a) Shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencës në fusha me interes të përbashkët;
- b) Shkëmbimit të eksperiencës mbi përdorimin e teknologjisë të policisë shkencore, si dhe mbi metodat dhe mjetet e kërkimit kriminologjik;
- c) Shkëmbimit të informacionit, njohurive dhe eksperiencës në fushën e kontrollit të kufijve, si dhe mbështetja materiale dhe teknike për shërbimet e kontrollit të pasaportave, me qëllim zbulimin e dokumenteve të falsifikuara dhe të tjetërsuara dhe për të parandaluar hyrjen e paligjshme dhe imigracionin e paligjshëm;
- d) Shkëmbimit të mostrave të dokumenteve të reja të udhëtimit, vulave dhe llojeve të vizave, në mënyrë që të parandalohet dhe t'i jepet fund kalimit të paligjshëm të kufijve;
- e) Shkëmbimit të informacionit për parandalimin dhe shtypjen e çdo forme krimi, në veçanti të të gjitha akteve të terrorizmit, krimit të organizuar dhe trafikimit të paligjshëm të armëve dhe të materialeve radioaktive;
- f) Shkëmbimit të informacionit, eksperiencës, njohurive të specializuara dhe asistencës mbi metodat e reja të përdorura për prodhimin e drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, trafikimin ndërkombëtar të tyre, fshehjen dhe shpërndarjen e tyre, si dhe mbi metodat e reja për t'i luftuar ato, në përputhje me Konventën e Vetme mbi Drogat Narkotike të vitit 1961, e ndryshuar me Protokollin e Amendimit të vitit 1972, Konventën mbi Lëndët Psikotrope të vitit 1971 dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1988 kundër Trafikimit të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotrope;

- g) Shkëmbimit të legjislacionit për sa u përket specifikimeve në këtë marrëveshje;
- h) Shkëmbimit të publikimeve dhe rezultateve të kërkimeve shkencore në fushat që mbulohen nga kjo Marrëveshje.
- i) Trajnimet dhe formimet profesional të oficerëve të policisë.

Neni 3

Në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti i bashkëpunimit, palët do të mbajnë takime me ekspertë brenda kuadrit të kësaj marrëveshjeje, sa herë që të dyja palët bien dakord që kjo është e nevojshme.

Neni 4

1. Secila palë mund të dërgojë një ose më tepër oficerë ndërlidhës, pranë misionit të tij diplomatik apo autoritetit konsullor në territorin e palës tjetër, për një periudhë kohe të caktuar ose të papërcaktuar.
2. Oficerëve ndërlidhës do t'u jepen kompetenca informative dhe konsultuese. Në mënyrë të veçantë, detyrat e tyre do të përfshijnë:
 - a. Nxitjen e shkëmbimit të informacionit, me qëllim parandalimin dhe luftën kundër veprave penale.
 - b. Dhënien e ndihmës, lidhur me aktivitetet e autoriteteve kompetente për mbikëqyrjen e kufijve të jashtëm të shteteve të tyre.
3. Oficerët ndërlidhës nuk do të kenë detyra operationale.

Neni 5

1. Secila palë mund të refuzojë tërësisht apo pjesërisht bashkëpunimin në raste të tilla, kur mund të vihet në rrezik sovraniteti i saj kombëtar, siguria e saj ose interesat e saj kombëtarë ose kur kjo është në kundërshtim me legjislacionin kombëtar.

Refuzimi i bashkëpunimit do t'i shprehet me shkrim palës tjetër pa vonesë.
2. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje i nënshtrohet legjislacionit kombëtar të secilës palë.
3. Asnjë nga palët nuk do të bëjë publike apo të transferojë tek një vend i tretë asnjë informacion konfidencial, me përjashtim kur për këtë merret pëlqimi i palës tjetër.
4. Shërbimet përgjegjëse për zbatimin e kësaj marrëveshjeje janë:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë
Drejtoria e Standardeve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit
Për Këshillin e Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës
Sektori për bashkëpunimin ndërkombëtar në Ministrinë e Sigurisë

Për bashkëpunim të drejtpërdrejtë në raste shumë urgjente, palët do të shkëmbejnë një listë që përmban shërbimet e autorizuara përgjegjëse për komunikim dhe bashkëpunimin.

Neni 6

1. Palët do të krijojnë një Komitet Koordinimi, përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, i cili do të kryesohet nga Ministri i Brendshëm për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministri i Sigurisë për Këshillin e Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës ose nga përfaqësuesit e autorizuar të të dy ministrive, me pjesëmarrjen e ekspertëve. Komiteti i Koordinimit do të sigurojë gjithashtu nxitjen dhe vlerësimin e kësaj marrëveshjeje.

Përfaqësues të ministrive të tjera ose të autoriteteve qeveritare mund të marrin pjesë në takimet e këtij komiteti nëse është e nevojshme.

2. Komiteti i Koordinimit do të mbledhet në periudha të përcaktuara në bazë konsultimesh, në mënyrë të alternuar, në Republikën e Shqipërisë dhe në Bosnjë -Hercegovinë.

3. Gjuha angleze do të jetë gjuha me të cilën do të punohet, duke mos përjashtuar përdorimin e ndonjë gjuhe tjetër që flitet shumë.

Neni 7

Palët angazhohen të zbatojnë të gjitha dispozitat përkatëse që përfshihen në ligjet e tyre për mbrojtjen e të dhënave, gjatë shkëmbimit të çdo lloji të dhënash personale për qëllime të kësaj marrëveshjeje.

Neni 8

Kjo marrëveshje nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare që vendosin detyrime për palët.

Neni 9

I. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit nëpërmjet të cilit secila palë informon tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike rreth përmbushjes së procedurave të saj të brendshme përkatëse.

2. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila palë mund t'i japë fund kësaj marrëveshjeje mbi bazën e një njoftimi me shkrim që i komunikohet tridhjetë ditë më parë palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike.

3. Secila palë në çdo kohë mund ta pezullojë tërësisht ose pjesërisht zbatimin e kësaj marrëveshjeje për arsye të sigurisë kombëtare, rendit publik dhe shëndetit publik. Pezullimi, ashtu sikurse dhe tërheqja e palës nga marrëveshja do t'i komunikohet palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Si pezullimi ashtu dhe tërheqja e palës do të hyjnë në fuqi një ditë pas marrjes së njoftimit përkatës.

Neni 10

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet nëpërmjet miratimit të ndërsjellë ndërmjet palëve. Të gjitha ndryshimet dhe shtesat duhet të paraqiten me shkrim. Palët do të hyjnë në konsultime në lidhje me ndryshimet e kësaj marrëveshjeje, me kërkesën e secilës prej palëve me qëllim arritjen e një pëlqimi të përbashkët të palëve. Çdo ndryshim do të hyjë në fuqi sipas procedurës së përshkruar në paragrafin 1 të nenit 9.

Bërë në ..., më ... në dy kopje, origjinale në shqip, në gjuhët zyrtare të Bosnjës dhe Hercegovinës (boshnjake, kroate, serbe) dhe anglisht.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 5.8.2010

Doli nga shtypi më 7.8.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 32 lekë